



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:049495
Datë: 11.04.2024
Numri i dokumentit: 05563151

PPP.nr.18/24

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit S.B. nga Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson av Jeton Berisha nga Ferizaj, kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “S.”, me seli në Prishtinë, rr “...”, të cilën e përfaqëson B.M., për përmbartimin e aktgjykimit C.nr.1141/17, të datës 09.07.2019, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 11.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit Kompania e Sigurimeve “S.”, i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.64/2024, i datës 24.01.2024, i lëshuar nga përmbartuesi privat B.A. nga Ferizaj dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.64/2024, i datës 24.01.2024.

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.64/2024, të datës 24.01.2024, përmbartuesi privat B.A. e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit S.B., kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “S.”, për pagesën e kompensimit të dëmit në shumë të përgjithshme prej 7,945.48 euro, shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 2,236.96 euro, si dhe shpenzimet e përmbartimit, në bazë të aktgjykimit C.nr.1141/17, të datës 09.07.2019, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, ose ndalimin e mjeteve nga llogaritë bankare të debitorit dhe bartjen në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta pranoj prapësimin si të bazuar dhe ta anuloj urdhërin për përmbarim.

I autorizuari i kreditorit ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.64/2024, të datës 24.01.2024 dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi në fjalë është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Gjykata vlerëson se urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.64/2024, i datës 24.01.2024, i lëshuar nga përmbaruesi privat B.A., është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmbar shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore, ngase përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së.

Sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se : debitori me parashtrësën e datës 01.11.2023, iu ka drejtuar Gjykatës Themelore në Ferizaj për Gjykatën e Apelit për korrigjimin e aktgjykimit të Apelit Ac.nr.4316/19, të datës 06.10.2023, propozimi për korrigjim ka të bëjë me shpenzimet e procedurës të llogaritura sipas tarifës së OAK numri tarifor 6 e 7 për përfaqësim një paditës me vlerë mbi 10,000 euro për përgjegjësi S. 80%, janë llogaritur gabimisht, gjykata këtë pretendim e konsideron të pa bazuar sepse siç konstatohet nga shkresat e lëndës gjegjësisht nga aktgjykimi Ac.nr.4316/19, i dt. 06.10.2023, i lëshuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, vërtetohet se me këtë aktgjykim gjykata e shkallës së dytë e ka refuzuar ankesën e të paditurës, tani debitorit KS "S." dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë C.nr.1141/17, të dt. 09.07.2019, dhe për më tepër debitori në ankesën e tij kishte të drejtë që ti parashtrroj kërkesat eventuale të tij sa i përket edhe shumës së shpenzimeve të procedurës kontestimore të vendosura me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Për më tepër fakti që debitori në parashtrësën e dt. 01.11.2023, ka kërkuar korrigjimin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret sa i përket shumës së shpenzimeve të procedurës kontestimore, nuk është pengesë për përmbarimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë Cnr.1141/17, të dt. 09.07.2019. Përveç tjerash, në asnjë dispozitiv të Ligjit të Procedurës Kontestimore nuk është paraparë shprehimisht që parashtrësja e shkrim e dorëzuar nga palët ndërgjygjëse për përmirësimin e gabimeve teknike ta pengoj përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë, gjegjësisht të plotfuqishëm.

Po ashtu, pretendimi i debitorit në prapësim se: bazuar në propozimin për korrigjim të aktgjykimit dhe deri në vendosjen e gjykatës lidhur me këtë propozim debitori konsideron se urdhri për përmbarim është i parakohshëm. Kjo për faktin se debitori dhe i autorizuari i kreditorit janë dakorduar për shtyrjen e realizimit të kredisë deri në vendosjen nga Gjykata e Apelit lidhur me propozimin për korrigjimin e aktgjykimit, Gjykata konsideron se edhe ky pretendim nuk qëndron dhe është i pabazuar, sepse nga shkresat e lëndës, gjegjësisht nga prapësimi i debitorit nuk konstatohet se i njëjti i ka bashkangjitur prapësimin ndonjë provë me shkrim në bazë të cilës do të vërtetohej se është lidhur ndonjë marrëveshje me shkrim për mos ushtrimin e propozimit për përmbarim nga kreditori. Për më tepër, në nenin 69, par 4, të LPP-së, është paraparë shprehimisht : *“Baza për prapësimin duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim. Përndryshe prapësimi do të refuzohet”*.

Gjykata, po ashtu vlerëson se aktgjykimi i përmendur më lartë është në pajtim të plotë me nenin 36, par.1 të LPP-së, sepse siç vërtetohet i njëjti është i pajisur me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarushmëri, respektivisht aktgjykimi në fjalë është i plotfuqishëm me datë 06.10.2023, dhe i ekzekutueshëm me datë 24.11.2023. Po ashtu, aktgjykimi i cekur është i përshtatshëm për përmbarim në bazë të nenit 27, par 1, të LPP-së, për arsye se në të është treguar, kreditori dhe debitori si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata sa i përket kompetencës lidhur me vendosjen në prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin për përmbarim në rastin konkret, është mbështetur në nenin 109 par.3 të LPP-së, në të cilinë është paraparë shprehimisht se: *“Për debitorin si person juridik kompetente territorial është gjykata ku gjendet selia e personit juridik ose selia e njësisë organizative të tij, si dhe gjykata në territorin që ka nxjerr dokumentin përmbarues”*, që në këtë rast dokumenti përmbarimor, respektivisht aktgjykimi C.nr.1141/17, i dt.09.07.2019, është nxjerr nga Gjykata Themelore në Ferizaj.

Si përfundim, duke i marr për bazë të gjitha faktet e përmendura më lartë, gjykata konsideron se përmbaruesi privat B.A., urdhrin për përmbarim P.nr.64/2024, të datës 24.01.2024, e ka nxjerr në pajtim të plotë me nenin 22, par 1, nën par 1.1, 27, par 1 dhe nenin 36, par 1, të LPP-së.

Andaj, Gjykata duke i marr parasysh thëniet e debitorit në prapësim, thëniet e të autorizuarit të kreditorit në përgjigjen në prapësimin e debitorit, provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi që të njëjtin ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ndërsa urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.64/2024, i datës 24.01.2024, të mbetet në fuqi.

Nga të cekurat më lart, gjykata bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.18/24, më datë 11.04.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykates së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.